



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Kabinet of the Minister

DATË/E:	25.04.2019
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Drejtorin e Policisë së Kosovës z. Rashit Qalaj
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor z.Fatmir Matoshi, <i>[Signature]</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për ndalimin e djegieve të gomave me rastin e Ditës së 1 Majit, Dita e Punëtorëve

I nderuar z Qalaj,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kërkon që të mirren masa për të gjithë ata që ndezin goma me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Punëtorëve- 1 Majit, praktikë kjo e cila është e dëmshme për mjedisin dhe ndotjen e ajrit.

Ndezja e gomave dhe materialeve tjera, lirojnë dyoksina dhe okside të tjera që lirohen gjatë djegies së tyre dhe që shkaktojnë probleme serioze shëndetësore.

Djedia e gomave dhe materialeve tjera ndalohet me Ligjin Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligjin Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe ndëshkohet me Udhëzimin Administrativ Nr.06/2018 për Ndëshkimet me Gjobat Mandatore.

Andaj, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve dhe mjedisit , kërkojmë nga Policia e Kosovës, që të ndërmarrin masa për parandalimin e dukurive të tilla negative dhe ndaj personave të cilat veprojnë në kundërshtim me rregullat t'i shqiptohen masat ndëshkuese konform Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Ndëshkimet me Gjobat Mandatore dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Me respekt!

Faqe 1 nga 1

Adresa: ish pallati i mediave " Rilindja" kati 17, 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38 200 32 020;

<http://ëëë.mmph-ks.org>